



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 10.07.2023

Prot.3 (tre)

Protokoll nr. 3

I mbajtur sot më datë 10.07.2023, në mbledhjen jashtë radhe të Këshillit të Bashkisë Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës);
2. “Mbi miratimin e destinacionit të përdorimit të fondit të kërkuar për emergjencën civile të datës 15 Qershor në fshatrat Zëmlak e Plasë të Bashkisë Maliq”;

#### **Këshilltarë të pranishëm në sallë:**

Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; Rudina Bregu; Ildir Limllari; Petrit Kupe; Fevri Sherifi; Dritan Çami; Ronaldo Skënderi; Klea Baçi; Armando Dautllari; Yllson Ibrahimllari; Server Xhuti; Albina Xhejo; Faslli Zholi; Plator Çollaku; Eriseld Jonusllari; Xhuana Hoxhallari; Dalina Krekas; 18 (tetëmbëdhejtë) këshilltarë.

**Të pranishëm nga Administrata:** Zv/Kryetari i Bashkisë: z.Eridion Rustemi; Drejtore e Financës dhe Buxhetit: znjAlmira Muka;

**Ornildi Demollari:**Përhëndetje! Bazuar në ligjin 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore, kemi thirur këtë mbledhje jashtë radhe të Këshillit të bashkisë, me rend dite me një pikë, është një rast që ka patur disa dëmitime nga rreshjet e shiut në dy fshatra të NJ.A.Bazuar në ligjin 48/2018na jep mundësinë të thrasim një mbledhje jashtë radhe për emergjencat civile.Verifikojmë kurumin kemi 17 këshilltarë në sallë dhe (më pas shkon 18), mund të vijojmë me mbledhjen e deklaroj të hapur.Nga ekzekutivi mbledhjen po e shoqërojnë: Zv/Kryetari i Bashkisë: z.Eridion Rustemi; Drejtore e Financës dhe Buxhetit: znjAlmira Muka.Miratojmë rendin e ditë?

Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 18 vota pro. Faleminderit!

**Ornildi Demollari:**Ashtu siç thashë, kemi për rend dite kemi një pikë, e cila konsiston në një kërkesë e cila i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për të bërë të mundur ndërhyrje në dy fshatra të NJ.A Poja, përkatësisht në fshatrat Zëmlak dhe Plasë ku para dy





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

javësh rredhjet e shumta të shiut shkaktuan shumë dëme, në rrugët e fshatrave disa përenj dhe në banesa, por fatmirësisht dëmet ishin materiale. Menjëherë janë ngritur komisionet për evidentimin e dëmeve dhe vlersimi, janë përgatitur preventivat dhe ju janë dërguar Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, kërkesa për të mbuluar këto dëme. Ndoshta për më shumë detaje do flasin specialistët, Zv/Kryetari ose drejtoresha. Nuk e di ka ndonjë pyetje ose paqartësi?

**Pranvera Begolli:** Përshëndetje e pashë P-V dhe relacioni shpjegues, natyrisht është një vlerë që ju përgjigjet të gjitha preventivave që ka bërë Bashkia e Maliqit dhe besoj se të gjithë do jemi për ta mbështetur dhe për ta miratuar se ka të bëjë dirket me ndihmën ndaj komunitetit të NJ.A pojan, por do doja vetëm një shpjegim kjo shifër 111.995.304 lekë, nga cilat fonde do jetë, i Emergjencave Civile në bashki apo do na ndihmojë Agjencia, vetëm këtë shpjegim doja. Faleminderit!

**Ornildi Demollari:** Po thua fondi do jetë, nga fondi jonë i Emergjencave apo nga Agjencia Kombëtare?

**Pranvera Begolli:** Po.

**Petrit Kupe:** Kam e dhe unë diçka, e kemi parë problemin që keni ngritur sot dhe është një vërejtje për mendimin tim nga ana e bashkisë, për të stabilizuar gjendjen e krijuar. Kisha një pyetje lidhur me preventivin, a janë llogaritur problemet inxhinerike të këto rrugë që do të riasfaltohen, të këto rrugë janë kryer apo do kryhen kanalizimet e ujarve të zeza? Apo dhe rrjeti i ujit të pijshëm. Sepse nuk mund të kalojmë në asfaltim, e bëra këtë pyetje se nuk jam shumë i qartë.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit! Kemi diçka tjetër?

**Yllson Ibrahimllari:** Përshëndetje të gjithëve! I nderuar Kryetar, i nderuar nën/kryetar i bashkisë. Për sa i përket projektit në parim jemi dakord, sepse fatkeqësitë nuk kanë kah politik për tu diskutuar. Unë shikoj një preventiv i cili përveç detajimit, në ndjekjen që bëj zonës kam goxha pakënaqësi dhe për këtë arsye ne kemi bërë obeksionet tona të cilat do të paraqesi nën/kryetari i Këshillit Z.Faslli Zholi. Dua të kur ka qenë investimi i fundit në zonën Zëmlak Plasë? Me sa kam detaje është i vitit 2018. Në një psoitim në faqen zyrtar të Bashkisë Maliq i datë 14 qershor 2016, flitet për përmbytje në të njëjtën zonë, ku bashkia kishte marrë masa për stabilizimin e situatës, përmbytje e ndodhur në datën 13 qershor 2016. Kur është kryer investimi i fundit? Kush ka qenë firma fituese e projektit? Cili është situacioni? Cili është grupi që e kam marrë në dorzim investimin atje? Me sa di investim i vitit 2018, pastaj do hyjmë në objeksionet që i kemi paraqitur si grup. Faleminderit!

**Ornildi Demollari:** Faleminderit!

**Zv/Kryetari i Bashkisë: z.Eridion Rustemi:** Përshëndetje të gjithëve! Në radhë të parë ju falenderoj që jeni bërë pjesë e këtij takimi, në këtë mbledhje jashtë radhe. Për sa i përket sqarimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

të Këshilltares znj.Vera, doja të thoja që, ky është një fond që bashkia Maliq nëpërmjet një kërkesë i drejtohet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile sipas VKM-së 53 datë 01.02.2023 në rastet kur dëmi i shkaktuar nga fakeqësitë natyrore e tejkalon fondin që bashkia Maliq ka akorduar për Emergjencat Civile, atëherë i drejtohem Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për të kërkuar fonde mbështetës.Në rastin tonë, shqetësimi që kemi ne në Zëmbllak dhe Plasë sipas preventivit të hartuar nga Inxhinierët specialistë, dëmi e kalon me disa fish vlerën, fondet që ka në dispozicion bashkia Maliq për Emergjencat Civile nuk e plotësojnë dot dhe jemi brenda kritereve të VKM-së.Për sa i përket Këshilltarit z.Petrit Kupe, si do veprohet me dhe si do realizohet projekti në këto fshatra, në relacion shpjegohet me detaje se ku do të konsistojë ndërhyrja në këto fshatra, ku përfshihen kanalizimet e ujerva të zeza, ujësjellsa, prita malore, rehabilitimi i proit, rrugë, rrugët janë dhe me emërtime në fshatin Zëmbllak dpo ashtu dhe në Plasë, do veprohet në të gjithë infrastrukturën e dëmtuar pa përjashtim më vonë do shkohet në asfaltim dhe problemet e tjera.Për sa i përket shqetësimit të Këshilltarit të opozitës, është e vërtetë që atje janë kryer disa ndërhyrje për rehabilitimin e pritave malore, Plasë-Zëmbllak ashtu si kemi verpuar dhe në fshatin Zvezdë, por ashtu si të gjithë e kemi parë, ne ishim në terren, Kryetari i bashkisë ishte atje për rreth 10 orë bashkë me Prefektin e Qarkut, bashkë me të gjitha strukturat e bashkisë apo dhe me mjetet e Bordit Rajonal të Kullimit dhe me mjete private po ashtu.Të gjithë jemi koshjnetë ne si banorë të zonës, ajo ishte një katastrofë natyrore sipas diskutimeve që kmei bërë me banorë të zonës, kjo ndodh njëherë në 100 vjet.Kishte prurje të mëdha nga shpati i malit dhe ndodhi që ato dy prita malore të rikonstruara jo të ndërtuara nga e para, pësuan një dëmtim, dëmtim i cili solli ato dëme, por dëmet në Zëmbllak nuk erdhën vetëm prurjet e mëdha, por uji vërshonte nga të gjitha anët e fshatit.Nuk mendoj mendoj që shkak kryesor i përmabytjeve rë kenë qenë investimet e bëra më parë, apo të mos kryera si duhet.

**Yllson Ibrahimllari:**E kisha në përgjithësi dhe nuk doja të futesha në detaje, duhet të kalojmë një seancë me debat me të gjitha drejtoritë, këtu nuk është marrë mendimi fare i Emergjencave Civile dhe për këtë kam djeni të plotë ka një konflikt të pastër interesi ELVA shpk me drejutes teknik dhe në biznes z.Emin Toçi dhe prof.dr Sotiraq Pantazi për pritat dhe për digat, në fshatin Melçan të Gorës dhe konkretisht të kallzuar prej meje në SPAK, kanë përmbytur pemëtore AZHBR, pronën time me certifikatë, rrugën e fshatit dhe nuk është mbajtur asnjë qëndrim.Nëse do e marrim për ta diskutuar këtë pjesë, kjo është personale dhe kalon më vete, nëse neve do vazhdojmë të me firma të cilat i kanë sjellë komunitetit, njerëzve problematika në këtë bashki dhe ti marrim ata si yje të mendimit, vazhdojmë e bëjmë, rrugët ligjore atje janë, katër kallëzime penale janë bërë dhe për disa drejtues të drejtorive tuaja.

**Ornildi Demollari:**Kolegë ju lutem, fokusohemi tek rendi i ditës. pastaj është tjetër çështje ajo, kemi diçka tjetër për rendin e ditës? Për që kemi?

**Faslli Zholi:**Ju falenderj të gjithëve!Kjo temë që ne po diskutojmë është me të vëretet një temë dhe një problem dhe jam plotësisht dakord se për këtë punë jemi të miratojmë vendime dhe tju



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

vimë në ndihmë qytetarve sa më mirë, aq më tepër në fatkeqësi si kjo që ndodhi në Zëmbalok dhe ne jemi koshjentë të gjithë dhe dua ta falenderoj dhe punën e bashkisë, për arsye se u gjet pranë banorve. Unë doja ta bëja dhe si pyeje, kryetari i grupit të këshilltarve të opozitës e tha, Zv/kryetari i bashkisë, e tha për punët që janë kryer dhe ne jemi koshjnet për punët që janë bërë në bashkinë e Maliqit. Por do thoja se atje në Zëmbalok, i di pritit nga vijnë, doja të thoja që këto investime, që ne i kemi bërë ose do i bëjmë dhe nuk i janë përgjigjur kohës, ky është shqetëimi jonë, që karxhohen para dhe a jemi në gjendje ti kapim ku i kemi harxhuar këto lekë. Tani që do marrim fonde nga qeveria nga Emergjencat Civile dhe unë jam dakord me Doktorin ne ta bëjmë debat këtë temë, në një moment tjetër për shumë probleme të tjera, qoftë dhe për rezevuarër, unë kam dhe disa shkresa këtu që mund tja u paraqis dhe që ti dalim në krye, të ketë një transparencë, që ne të kemi të ndërgjegjshëm, sidomos ne që jemi këtu, të dimë se çfarë tju themi qytetarve dhe të jemi koshjentë për ato që mednojmë dhe do vendosim, mos votojmë kuturu, jam plotësisht dakord ta votojmë P-V dhe tju vimë në ndihmë qytetarve. Ju faleminderit!

**Ornildi Demollari:**Faleminderit!Po Ildir.

**Idlir Limllari:**Kisha një propozim lidhe me këtë shqetësim, se e vërtet është që bëhen punime dhe shkatrohen, ne duhet të kërkojmë një garanci më të madhe, sepse këto punimet e pritave bëhmen me garanci 1 ose 2 vjeçare, le të jetë garancia 5 vjet, garancia 1 vit, vetëm 1 dimër është, ti kërkojmë dërmës së ndërtimit garanci më të lartë.Faleminderit!

**Ornildi Demollari:**Faleminderit!Po Fevri.

**Fevri Sherifi:**Shqetësimi është mjaft i madh në Zëmbalok, mbasi nuk ka ndodhur asnjë vit kjo gjendje që ndodhi këtë herë.Bashkia ka qënduar shumë afër njerzve dhe ne kemi mendim të miratohet P-V, pasi shqetësimi është shumë me vend.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit!Po Petrit.

**Petrit Kupe:**I kam parë preventivat dhe problemi që shtrova, nuk morra përgjigjen e duhur sepse pashë në punime që për riasfaltimin e rrigve nuk ka të parshikuara ndërhyrje në ujrat e zeza apo të ujit të pijshëm, mëqëse ky preventiv thuhet që është në fazën e përafërt të projekt-idesë të shokohen më hollësisht këto rrugë që do riasfaltohen, për ti shtuar në preventivin e afërt që do bëhet për realizimin e investimeve.Pavarsisht se kjo është një projekt-ide dhe mund ketë plus dhe minus, preventivi i saktë do i ketë të gjitha këto dhe ne duhet ta miratojmë patjetër këtë kërkesë drejtuar Emergjencave Civile dhe kjo është në të mirë të komunitetit, atyre që janë dëmtuar sepse do bëhen investime të reja më të mira dhe ndoshta do eliminohen dukuri të tilla.E dyta ne duhet të kërkojmë dhe një garanci në miratimin e këtoj fondi, të bëhet përpjekje nga ana e bashkisë nëpërmjet qeverisë të bëhet e mundur, çelja e fondit, sepse është një fond i konsiderueshëm, bashkia po mos çelet fondi nga buxheti i shtetit do konsumojë pjesë, pjesë nga buxheti i vetë, do ngelen investime pa bërë në fshatra të tjerë, ne duhet ta shohim me opzimizëm dhe ta mbështetim dhe të informohemi deri ku është procesi i miratimit të fondit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Ornildi Demollari:**Faleminderit!Kemi të drejtën ligjore të ndjekim hap pas hapi për zhvillin dhe zbatimin e punimeve.

~~Vilson Ibrahimllari:~~Në emër të këshilltarve të grupit të opozitës, shprehim votën pro, por besoj që në sensin e monitorimit të auditimit të një projekti, që mos fshihemi mbas fatkeqësive që na ndodhin, të bëjmë një preventiv paraprak të asaj që mund të na ndodhi në bashki, do të thotë këtë preventiv që kemi sjellë, unë mendoj që Këshilli ka kapacitetet njerzore që mund të ngrejë një komison auditimi sipas fazave dhe sipas fondeve.Faleminderit!

**Ornildi Demollari:**Faleminderit!Kemi diçka tjetër?

**Pranvera Begolli:**E përmenda dhe në fillim, kemi ardhur për ti miratur diçka në ndihmë të komunitetit, dëgjova problemet që ngritën kolegët, thanë mednimet e tyre dhe deri diku i mbështes, por më duket se nuk kanë dëshirën e mirë, Idlir është inxhiner ndërtimi dhe është profesionist dhe kur flet një specialist besoj se duhet tja vemë veshin dhe ta dëgjojmë, kështu që komnetet e tjera kush me merr tenderin dhe kush e merr, nuk janë pjesë e procedurave të këshilli, spese janë procedura që i ndjek bashkia, çdo kush duhet të dijë pozicionin si duhet të flasë.Ju faleminderit dhe them të kalojmë në votim.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit! E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.


Miratohet me 18 vota pro. Faleminderit!

**Ornildi Demollari:**Shpresoj që të gjitha shqetësimet që u thanë nga kolegët të ndiqen hap pas hapi dhe punimet të bëhen sa më cilësore.Kemi diçka tjetër? Doja të thoja që duhet të ecim me kryetarët e fshatrave.Të përagtitim punën dhe ndarjen e kolegeve që do ndjekin këtë proces.Nëse nuk kemi diçka tjetër? Ju falenderoj.

Mbledhja mbyllet!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 21.07.2023

Prot.4 (katër)

Protokoll nr. 4

I mbajtur sot më datë 21.07.2023, në mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.06.2023;
3. P-V "Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin qershor 2023";
4. P-V "Për dhënien e Ndhmës Financiare për shërbimin mjekësor për fëmijët në nevojë në kuadër të bashkëfinancimit të projektit për Qendrën Komunitare Maliq, në bashkëpunim me BULGARIAN DEVELOPMENT AID";
5. P-V "Mbi miratimin e projektit "Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit me aftësi të kufizuara" me financim të përbashkët nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Maliq";
6. P-V "Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Maliq, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e znj.Lirika Demir banesa e të cilës është dëmtuar si rezultat i rënies së zjarrit.
7. P-V "Për miratimin e Planit Vendor të Emergjencave Civile në Bashkinë Maliq";
8. P-V "Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afat-mesëm 2024-2026 në nivel programi";
9. P-V "Për ngritjen e Komisioneve të përhershme të Këshillit të Bashkisë Maliq";
10. Diskutime të tjera.

#### **Këshilltarë të pranishëm në sallë:**

Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; Xhuana Hoxhallari; Floreta Zaçe; Ildir Limllari; Enida Avdolli; Gentiana Drabo; Marianthi Avrami; Petrit Kupe; Fevri Sherifi; Dritan Çami; Ronaldo Skënderi; Klea Baçi; Nersida Shindo; Server Xhuti; Faslli Zholi; Eglantina Balli; Andonaq Risto; Aleksandra Spaho; Lulëzim Hoxhaj; Dalina Krekas; Aramando Dautllari; 22(njëzetëdy) këshilltarë.

#### **Të pranishëm nga Administrata:**

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu; Drejtore e Financës dhe Buxhetit znj.Almira Muka; Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social znj.Ermanda Petriti; Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile z.Stiljan Belishta.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Ornildi Demollari:** Përshëndetje! Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, kemi thirrur këtë mbledhje të radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq, me rend dite prej 10 pikash, po të marrim dhe pikën diskutime të tjera. Mbledhja nga ekzekutivi po shoqërohet nga Kryetari, para se të fillojmë me rendin e ditës, verifikojmë korumin, korumi realizohet, jemi 19 këshilltarë në sallë, numri shkon në 22 këshilltarë.

Vazhdojmë me rendin e ditës dhe mbledhjen e deklarojmë të hapur.

Miratojmë rendin e ditës?

Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 19 vota pro. Faleminderit!

Më lejoni t’ju njoh me vendimet e mbledhjes së datës 30.06.2023, janë 7 vendime, 3 me karakter normativ dhe 4 me karakter kolektiv, vendimet me karakter normativ shkojnë në Prefekturë, të 3 vendimet janë konfirmuar nga Prefekti.

#### **Vendim nr.73, datë 30.06.2023**

“Për miratimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit të projektit të përbashkët të Bashkisë Maliq dhe Këshillit të Qarkut Korçë, me qëllim “Mbrotjtjen dhe përfshirjen sociale për të moshuarit”;

#### **Vendim nr.74, datë 30.06.2023**

“Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm për vitet 2024-2026”;

#### **Vendim nr.75, datë 30.06.2023**

“Për mbështetjen financiare të aplikantëve, banorë të bashkisë Maliq në vijim të programit të Qeverisë Shqiptare “Programi i Kodimit”;

Këto ishin vendimet me karakter kolektiv, që kanë marrë dakortësinë e Institucionit të Prefekturës. Më poshtë po ju përcjell 4 vendimet me karakter kolektiv.

#### **Vendim nr.70, datë 30.06.2023**

Miratimin e raportit hartuar nga Komisioni i mandateve pranë Këshillit të bashkisë Maliq, për dhënien e mandatit të këshilltarit bashkiak z.Petrit Kupe dhe z.Ilia Xhuti;

#### **Vendim nr.71, datë 30.06.2023**

“Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin maj 2023”;

#### **Vendim nr.72, datë 30.06.2023**

“Për miratimin e Ndhmës Ekonomike nga fondi i bashkisë Maliq për muajin maj 2023”;

#### **Vendim nr.76, datë 30.06.2023**

“Për kontribut ne fuqi punëtor edhe materiale”

Si rregull duhet të miratojmë protokollin e mbledhjes së kaluar.

Kush është dakord protokollin e mbledhjes së kaluar?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet protokollin e mbledhjes së kaluar me 21 vota pro. Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kalojmë te pika e 3-të e rendit të ditës, “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin qershor 2023”; Jemi te P-V i ndihmës ekonomike, por do doja të shtoja dhe diçka, së fundimi na ka ardhur dhe një P-V që ka të bëjë me bursat e nxënësve të arsimit të mesëm. Materiali ju është vënë në dispozicion dhe besoj se do kemi mirëkuptimin tuaj për ta marrë në konsideratë?

Jemi te pika e 3-të, P-V “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin qershor 2023”, Ka ndonjë pyetje?

**Faslli Zholi:** Faleminderit Kryetar i Këshillit, faleminderit Kryetar i Bashkisë, faleminderit kolegë Këshilltarë! Për sa i përket ndihmës ekonomike, por kam disa gjera, me një vëzhgim që i kam bërë listës, shoh disa lekë që janë shpenzuar në mënyrë jo të mirë, për sot nuk po e bëjmë debat, do kërkojmë informacion më shumë në një moment tjetër. Faleminderit!  
Janë disi familje që nuk jetojnë në Shqipëri dhe përtojnë Ndhimë Ekonomike nga fondi 6%.

**Ornildi Demollari:** Ka ndonjë pyetje tjetër? Kryetar do shtosh diçka?

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Nëse këshilltari ka diçka të tillë, le të na i thotë dhe na shërben dhe ne. E falenderoj.

**Faslli Zholi:** Faleminderit Kryetar! Patjetër që janë në listat.

**Ornildi Demollari:** Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 21 vota pro. Faleminderit!

Kalojmë te pika e 4-të e rendit të ditës, P-V “Për dhënie e Ndhmës Financiare për shërbimin mjekësor për fëmijët në nevojë në kuadër të bashkëfinancimit të projektit për Qendrën Komunitare Maliq, në bashkëpunim me BULGARIAN DEVELOPMENT AID” dhe Ambasadën Bullgare:

Ka ndonjë pyetje? kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 21 vota pro. Faleminderit!

Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës, P-V “Mbi miratimin e projektit “Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit me aftësi të kufizuara” me financim të përbashkët nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Maliq”;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ka ndonjë pyetje? Kryetar do shtosh diçka?

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Bëhet fjalë për të moshuar që kanë problematika të ndryshme, ata nuk do të vijnë tek institucionet tona, por ne do të shkojmë tek ata, është një shërbim i ri që financohet nga Ministrisa e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Kombëtar Sociale Shtetëror.

Në konceptimin tim është një projekt shumë pozitiv dhe shpresojmë që projekte të tilla sociale të jenë më të shpeshta dhe të jenë sa më afër familjeve në nevojë dhe fëmijeve me probleme, apo të gjithë ata që kanë nevojë për psikologë, punonjës socialë, punonjës sanitarë etj.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit! Po.

**Aleksandra Spaho:** Projekti është vetëm për Maliqin qendër? Apo dhe për njësitë administrative e tjera?

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Bashkia është e madhe dhe nuk ka pasur ndarje asnjëherë, midis njësive administrative dhe qendrës. E rëndësishme është që Shërbimi Social jetë sa më afër njerzëve pavarësisht se ku ndodhen ata. Ajo çka mund tju them, nëse këshilltarët kanë informacion që ne na mungon, jeni të mirëpritur të na i realtoni dhe zyrat tona në bashki dhe njësitë administrative do jenë afër komuniteteve në nevojë.

**Ornildi Demollari:** Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 22 vota pro pika 5 e rendit të ditës.Faleminderit! (mbledhjes i bashkohet dhe znj.Eglantina Balli).

Dua të ndalem dhe te P-V për bursat e arsimit të mesëm të përgjithshëm viti 2022-2023 nga fondet e bashkisë. Doja që diskutonim menjëherë pas P-V të ndihmës ekonomike, por e kaluam. Urdhëro Kryetar!

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Të shpjegoj diçka në fakt nuk është dhënie bursash, por është një mbulim i shpenzimeve për efekt të pagesës të bursave, në totalin e përgjithshëm një pjesë fondeve i çel Ministria e Arsimit për bursat e arsimit të mesëm të përgjithshëm, por në momentin kur ne japim bursa, por kemi kërkesa më shumë se numir që mbulon Ministria e Arsimit, atëhere e mbulojmë me të ardhurat tona, ky është vitit i parë që ndodh, ndaj po shtojmë tani këtë fond, po e mbulojmë përsëri me fondet e arsimit, fondet janë kursyer nga një vit më parë, nga fondet e pagave, që kanë të bëjnë me arsimin parashkollor apo parauniversitar. Këto fonde duam ti përdorim dhe të mbulojmë 100% gjithë pagesat e bursave arsimit të mesëm të përgjithshëm për gjithë bashkinë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Lulëzim Hoxhaj:** Kush është kriteri për dhënen e bursave? Kriteri ekonomik apo kriteri i notave?

~~**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Është një VKM e cila ka përcaktuar kriteret kush përfiton bursën për arsimin e mesëm dhe studentët. Ne bazohemi vetëm në to, ajo që unë marr indicie dhe besoj se do e realizojmë shumë shpjet, ka të bëjë me nxënësit ekselentë, që do kemi një fond të dedikuar vetëm për ta dhe shpresoj që kjo të jetë në rritje se kemi nevojë për nxënës të kësaj kategorie.~~

**Ornildi Demollari:** Në dokument specifikohet kriteri ekonomike rast pas rasti.

**Aleksandra Spaho:** Ndodh që për një arsye ose tjetër, familja e studentëve ose nxënësve që trajtohet me Ndhimë Ekonomike, por pezullohet për 6 muaj nga Ndhimja Ekonomike. Ne si bashki kemi të drejtë mos e përjashtojmë që i mungon ky dokument?

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Tani nuk jemi në atë fazë, në të cilën dhe ne po miratojmë bursa. Atje ka një sërë kriteresh që mund ta përfitosh bursën, njëri prej tyre dhe më i rëndësishmi është kriteri ekonomik, por ka dhe kriterë të tjerë nga më të ndryshmet, si fëmijë jetim dhe me probleme të tjera. Atë që e përcakton udhëzimi, por bashkia me fondet e veta mund të bëjë si e mendon, e rëndësishme është të mos abuzohet, mos ketë favorizime. Ne kur miratojmë listat me bursat jemi munduar që të trajtojmë gjithë kërkesat për bursa dhe me fondet tona. Kush ka qenë këshilltar i vjetër, kam menduar në çdo rast bursat nuk kanë të bëjnë me politikën, burasat kanë të bëjnë me fëmijët dhe a kemi mundësi t'i trajtojmë dhe t'i ndihmojmë të gjithë. Politika te fëmijët duhet të jetë zero. Faleminderit!

**Ornildi Demollari:** Faleminderit Kryetar dhe për këtë mesazh që dhe!

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 22 vota pro. Faleminderit!

Suksese nënxësve!

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Maliq, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e znj.Lirika Demir banesa e të cilës është dëmtuar si rezultat i rënies së zjarrit." Është një zonjë kryefamiljare që i është djegur banesa e saj. Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 22 vota pro. Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e Planit Vendor të Emergjencave Civile në Bashkinë Maliq”, ka ndonjë pyetje?

**Kryetari i Bashkisë z. Gözim Topçiu:** Është një detyrim ligjor që ne duhet të miratojmë një plan për emergjencat civile dhe krizat në situata të vështira. Ndaj dhe ligjvënësi ka menduar që dhe ne duhet të parashtrijmë një plan për menaxhimin të emergjencave civile dhe krizat, është një plan standard, i miratuar nga instancat përkatëse, që vjen nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe vjen deri në nivele bashkie dhe në këtë aspekt ne sjellim pranë Këshillit për një miratim në parim dhe pastaj gjithë strukturat operacionale nga Kryetari i Bashkisë dhe gjithë strukturat e tjera të Emergjencave Civile.

Materiali është goxha voluminoz me nocione, me terma që përmbushin atë që Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile na i prezanton ne dhe parashikon. Ka shumë akte ligjore për këtë qëllim. Sapo kam përfunduar një takim për këtë qëllim.

Sot kemi struktura të ngritura si MSZH, e cila nuk qenë para disa vitesh, kemi tre mjete të Shërbimit Zjarrfikës, të cilët në çdo situatë kanë qenë nga më rezultativët, për këtë jemi vlerësuar dhe nga donatorë të huaj, punonjësit tanë janë vlerësuar dhe me çmime për këtë qëllim, kemi një organikë të plotësaplotësuar në 100%.

Shumë pozitive që qeveria ka marrë disa vendimmarrje për efekt të rritjes së pagës për Shërbimin Zjarrfikës, të shpresojmë që ky shërbim të ketë sa më shumë efikasitet, ne jemi në fazën e blerjes së mjetit me kosh për shërbimet në lartësi, për katet e sipërme.

Ne kemi parshikuar në fondet e Emergjencave Civile të këtij viti dhe do e realizojmë shumë shpejt. Jemi në rakordim dhe me Ambasadën Japoneze për blerjen e një mjeti tjetër, ju dhashë 4-5 pika për një strukturë, por ato janë të shumta nga Ujtije-Kullim, Policia e Shtetit, Kryetarët e fshatrave, vullnetarë, etj.

Ka shumë elementë që ky plan i parashikon në mënyrë me pika dhe na orienton ne t'i ndjekim sipas situatave hap pas hapi që ne na ndodhin apo dhe t'i parshikojmë vetë ashtu si na parshikon ligji për këtë qëllim.

Kush ka pyetje jam gati t'i përgjigjem.

Dua të falenderoj strukturat për menaxhimin e situatës në fshatin Zëmlak, banorët na kanë falenderuar për shpjetësinë e veprimit dhe shpresoj të kemi ndërhyrje për rehabilitimin në Zëmlak dhe Plasë, falenderoj dhe këshillin për miratimin në mbledhjen e mëparshme ku nuk kam qenë prezenet.

Të shpresojmë që ai fond të jetë efektiv dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ta miratojë sa më shpejt.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit Kryetar!

**Pranvera Begolli:** Kam dy pyetje? Materialin e kam parë dhe është me vlera për emergjencat, këtu ku thotë struktura drejtuese mbështetëse, Agjencia e Ujësjellës-Kanalizimeve, këtë strukturë nuk e ka më bashkia, ka kaluar pjesë e Ujësjellësit Korçë sh.a.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Jo çdo strukturë është në vartësi të bashkisë, por ligji i Kryetarit të bashkisë i thërret në raport dhe kërkon të meren masa nga të gjithë strukturat nga Komisarati i Policisë dhe deri te Ujësellësi, përveç strukturave që ka në vartësi.

~~Në raste emergjente në ndërhyjmë deri në marrjen forcërisht të mjeteve private për efekt të një shtate që shpëton jetë njerëzish.~~

Nuk mund t'i diskutojmë elementet e veçantë këtu, por po flasim për disa piketa ligjore. Në mbledhjen që do bëjmë, të strukturave bazë të Emergjencave Civile jeni të ftuar të bëheni pjesë, ku do të diskutohen elementë të veçantë dhe ne jemi të hapur të marrim dhe sugjerime për përmirësimin e punës, pasi ka shumë elementë që kërkojnë angazhimin e të gjithëve.

**Pranvera Begolli:** Dhe diçka tjetër, këtu te Komisioni Vendor i Planifikimit të Përballimit të Emergjencave, thuhet sigurimin e vendstrehimeve të përkohëshme në rast të fatkeqësive, si mund ta kuptojmë?

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Lufta në Ukrainë, na mësoi se dhe ato duhet të pastrohen, sepse situatat ndryshojnë. Në këtë prizëm duhet të pastrojmë e t'i lirojmë vendstrehimet, masat për Emergjenat Civile merren në kohë paqeje jo lufte.

**Pranvera Begolli:** Faleminderit!

**Ornildi Demollari:** Faleminderit Kryetar! Ka ndonjë pyetje?

**Lulëzim Hoxhaj:** Dua të them diçka në parim, para 4 vjetësh në qytetin e Athinës, Greqi, ra një zjarr dhe rrethoi një pjesë të Athinës, njerëzit shkuan rreth detit ku gjetën vdekjen. Arsyeja kryesore ishte që nuk u njoftuan në kohë, mos shkonin drejt detit.

Unë mendoj që çështja e Emergjencave Civile është sensitive, duhet parë me perspektivë, jam dakord që do blihet bazë materiale, por për mua kryesore është komunikimi me komunitetin, kjo mund të realizohet dhe nëpërmjet teknologjisë.

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Kjo është shumë e vërtetë, por plani nuk e ka të hedhur në letër çdo gjë që do ndodhë, ka vetëm piketat, po ju jap një element, ne fillojmë takimet me kryetarët e fshatrave, barinjtë për çdo fshat, të cilët janë baza për neutralizimin e zjarrit për çdo fshat.

Këta kanë zona të përcaktuara për të mbajtur në vëzhgim, kjo na ka dhënë shumë rezultat, ne jemi të hapur t'i dëgjojmë ata që na japin ide për t'i futur në këto plane. Në momentin që ndodh zjarri, është e vështirë t'i mbledhësh këto struktura, duhet bërë më parë si plan dhe duhet të ketë përgjegjësi për çdo drejtues.

Jemi në këtë linjë, nuk e di a i keni ngritur komisionet e Këshillit? Komisionet do jenë pjesë e punës.

**Aleksandra Spaho:** Po flas në emër të grupit, ne herën e kaluar kemi ngritur një grup si opozitë, besoj se Sekretari i Këshillit ju ka venë në djeni, për emrat dhe Kryetarin e grupit, unë jam



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nën/kryetari i grupit. Në lidhje me emergjencat kemi një kërkesë në katër kopje, që do ja dorëzojmë Kryetarit të Bashkisë dhe secilit nga grupet politike. Po ja jap fjalën z.Faslli Zholi për më tepër.

**Faslli Zholi:** Më falni për kohën! Duke marrë shkas dhe nga emergjencat, ato që u thanë janë të vërteta, sepse Plani i Emergjencave është shumë i gjerë. Në emër të opozitës së bashkuar ne kemi bërë një kërkesë të detajuar, do ju a vemë në dispozicion dhe grupit të PS-së, Kryetarit të Bashkisë, Kryetarit të Këshillit për ta parë.

Ne kemi kërkuar një debat për këtë qëllim, sepse është një gamë e gjerë, ne jemi dakord për të miratuar, por duhen parë me kujdes rrisqet që sjellin problemet dhe fondet.

Mund të më jepni katër minuta kohë t'ja u lexoj problemin ose ta shikoni dhe mendoj se ky do jetë një debat që do i shërbejë në të mirë të dyja palëve politike dhe komitetit.

**Ornildi Demollari:** Nëse e keni përgatitur në kopje materialin na i vini në dispozicion.

**Faslli Zholi:** Po patjetër e kemi për të gjitha palët. Ne kemi të drejtën e fjalës në Këshill.

**Ornildi Demollari:** Mundohuni të jeni sa më objektiv.

**Faslli Zholi:** Po patjetër ne jemi shumë objektiv në ato që themi. Ne po kërkojmë ato që tha Kryetari, të jemi në gatishmëri për emergjencat, të shohim ku janë detyrat që ka vendosur qeveria apo bashkia dhe për këtë qëllim të kemi një informacion nga pyjet, ujtje-kullimi dhe të tjerë për punën e tyre. Vështirësi ka patjetër, por t'i zgjidhim bashkë. Faleminderit!

**Ornildi Demollari:** Kryetar keni diçka?

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Nuk e kuptova thelbin e asaj çka kërkojnë? Pasi duhet të ndajmë disa gjera, ligji parashikon çfarë kompetence ka Këshilli i Bashkisë, nëse ka një pikë, unë e citova dhe më parë Këshilli i Bashkisë është i hapur të japë mendime, por nuk mund të zvëndësojë organin ekzekutiv.

Kryetari i Bashkisë është organ ekzekutiv, unë nuk dua të marr asnjë kompetencë të Këshillit të Bashkisë, por nuk mund të toleroj që asnjë kompetencë e imja t'i kalojë Këshillit të Bashkisë e para, e dyta jam shumë dakord që Këshilli të kërkojë informacion nga të gjithë strukturat tona, që janë pjesë e Emergjencave Civile dhe ne jemi të gatshëm, e kemi për detyrë t'ju shpjegojmë atë çfarë ju kërkon, çdo grup ka të drejtë të thërrasë Kryetarin e Bashkisë për çdo informacion që ju duhet.

Kryetari i Bashkisë ose vjen vetë ose sjell dikë tjetër, përfaqësimi në Këshillin e Bashkisë bëhet me Kryetarin e Bashkisë apo me personin e autorizuar prej tij në varësi të problematikës që kërkon Këshilli.

Kështu në këtë prizëm nuk duhet të themi që duam debat, nëse ligji e parashikon këtë ma thoni, nëse kërkon informacion ja u sjellim. Informacioni të jetë për atë çka ju keni nevojë dhe të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

bëheni pjesë me mendimet tuaja për përmirësimin e situatës dhe jo në futjen në ngërç të strukturave tona me ide që ndonjëherë politikisht e prishin.

Unë si kryetar në marrëdhënie me Këshillin, pjesën politike e shumëzohj me zero. Jeni të mirëpritur në çdo rast nëse keni ide për përmirësimin e punës dhe patjetër do ju dëgjoj me vëmendje, t'i shtojmë në panet tona, se nga idetë e mira dhe ato që përmirësojnë punën, nuk ka asgjë të keqe.

Përkundrazi rregullojnë punë, pasi flasim për emergjenca në të gjithë nivelet, e tha mirë z.Faslli mund të ketë nevojë diku dhe ne duhet të jemi të gjithë atje. Unë nuk kam asgjë të keqe ta lexoj të gjithë materialin, por termi debat nuk ishte i duhuri, duket sikur nuk jeni për të rregulluar punën, nëse keni sjellë shetësime apo ide ne jemi të hapur, ligji parshikon nenin 54 dhe 64 për kompetencat e strukturave tona që jemi të detyruar t'i zbatojmë. Faleminderit!

**Faslli Zholi:** Të falenderoj! Unë nuk dua të marr asnjë kompetencë, ne kemi bërë kërkesën dhe thamë debat për drejtoritë të na jpin informacion, diskutim me debat, të japim mendime për të mirën e punës, ndaj dhe ne e kemi bërë këtë kërkesë, që përgjigjësia të shkarkohet atje ku duhet. Faleminderit!

**Pranvera Begolli:** Ne kemi për të shqyrtuar P-V nr.9 në lidhje me Komisionet e Këshillit, unë mendoj që për problemet të ngrihen në bazë të komisioneve. Të mbyllet kjo dhe të kalojmë te pikat e tjera.

**Aleksandra Spaho:** Jam dakord me atë që tha Kryetari i Bashkisë, ne kemi disa paqartësi dhe kërkojmë informacion. Nëse na i pranoni kërkesën do e dorzojmë dhe nëse jemi kunda ligjit dhe kërkesa nuk pranohet, mund ta ktheni me shkrim që ju nuk hartoni dot një kërkesë.

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Po thoni diçka që nuk u përmendën këtu.

**Ornildi Demollari:** Do ju lutesha që kërkesën që keni bërë të na i adresoni secilit dhe do e shohim dhe diskutojmë në një mbledhje tjetër. Tani kemi diçka tjetër rreth kësaj? E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 22 vota pro. Faleminderit!

Kalojmë te pika 8 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afat-mesëm 2024-2026 në nivel programi", jemi te pika e 8-të e rendit të ditës.

**Petrit Kupe:** Lidhur me P-V, është një parashikim që duhet të kalojë, duhet të miratohet.

**Ornildi Demollari:** Në rregull, Po Kryetar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Kjo është një procedurë standarde që ne e realizojmë çdo vit, e kemi kaluar dhe me Këshillin e mëparshëm, kemi bërë dhe një kalim edhe para disa kohësh, pas rekomandimeve që na solli Ministria e

~~Financave pas çdo vendimi që ne marrim për tavanet buxhetore, pasi tavanet buxhetore janë përqindjet që qeveria i vendos dhe për organet e qeverisjes vendore, për shtesat që ajo mendon të akordojë, me transferat e pakushtëzuara vit pas viti.~~

Ne bëjmë një rishpërndaje sipas grupeve buxhetore, sipas strukturave buxhetore që kemi në bashki dhe M.Financave me disa rekomandime të vogla ka miratuar të gjitha propozimet tona dhe tani pas rekomandimeve që ka sjellë, ne kemi sjellë miratimin e taveve përfundimtare të cilat janë një miratim në parim dhe kur vjen fundviti të cilat bëhen fakt i kryer i të të gjitha vlerave buxhetore, si të transfertave si të buxhetit të pavaruar, atëherë ka vendimmarrje të këshillit për çdo element.

Nuk ka zëra të veçantë për atë që do bëjmë për vitin 2024, por vetëm shumëzime të vlerave të një vitit më parë me tre vitet që vijnë, me tavanet e përcaktuara nga qeveria me një vendim të veçantë. Nëse keni elementë të veçantë, kemi Almën Shafen e Financës e cila do japi detaje.

**Ornildi Demollari:** Drejtoreshë, ka diçka? Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 22 vota pro pika 8. Faleminderit!

*P-V "Për ngritjen e Komisioneve të përhershme të Këshillit të Bashkisë Maliq", në një mbeldhje më parë kemi nisur punën për ngritjen e komisioneve, bazuar në ligjin përkatës dhe rregulloren e këshillit dhe grupet politike brenda këshillit kanë sjellë propozime për secilin nga komisionet.*

*Janë gjithsej 14 komisione të përbërë nga 5 anëtarë, të cilat janë sjellë në formën e një projekt-vendimi për t'u diskutuar dhe miratuar dhe pastaj të nisin punën e tyre. Ka ndonjë pyetje? Ndonjë koment?*

**Aleksandra Spaho:** Sot po flas në emër të grupit, në lidhje me komisionet Partia Socialiste i ka numrat, por përderisa na takon 1/3 e komisioneve për të drejtuar, nëse jeni dakord dhe ju.

**Faslli Zholi:** Komisionet janë organizma të punës dhe sipas rregullores, te komisionet duhet të shërbejnë të gjithë si opozita dhe mazhoranca kjo është e rëndësishme, pastaj kryesimin si do jetë e zgjidhin anëtarët vetë.

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Mund të themi diçka? Edhe pse kjo është funksion i këshillit, dua të jap një sugjerim, komisionet karshi çdo emri duhet të kenë dhe arsimin përaktës, për mendimin tim për të krijuar dhe një ide për çdo anëtar dhe do sugjeroja që kryesimet e komisioneve t'i bëjnë specialistët sipas fushave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni nuk është vendimmarrës, por diskuton një material që vjen nga ekzekutivi dhe vete në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me disa ide, për përmirësimin e punës së dhënies së disa ideve shteruese për gjithë këshillin, sepse vjen më i specializuar.

**Ornildi Demollari:** Kemi diçka tjetër?

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Mendoj që dhe grupi i opozitës duhet të japë disa mendime për këtë propozim që kam dhe nuk duhet të miratohet sot projekt-vendimi me doemos. Komisionet sipas fushës japin mendime shteruese në mbledhjen e këshillit pa u zgjatur me diskutime të tjera.

**Ornildi Demollari:** Me mirëkuptimin tuaj t'i japim dhe pak kohë opozitës, kanë dhe disa gjëra për të diskutuar dhe ta shtyjmë për një mbledhje të radhës këtë çështje.

**Petrit Kupe:** Ta miratojmë në parim, pastaj kryesimin e komisioneve pretenduar nga opozita e vendosim më vonë.

**Ornildi Demollari:** Dakord!

E kalojmë në votim në parim?

Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 22 vota pro. Faleminderit!

Me kushtin që ka akoma për të diskutuar për kryesimin dhe për ndryshime. Jemi te pika e fundit e rendit të ditës. Diskutime të tjera, doja t'ja jepja fjalën një zonje që ndodhet në sallë se ka një shqetësim dhe ju lutem ta dëgjojmë.

*Anita Dautllari: Përshëndetje! Jam Anita Dautllari, banoj në fshatin Sovjan, kam dhe unë disa probleme shqetëuese në familje, vetë jam e sëmurë, kam dhe dy fëmijë për operacion dhe nuk kam mundësi. Kam tre vjet që kam bërë një kërkesë për ndihmë financiare. Do ju lutem të më ndihmoni.*

**Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social znj.Ermanda Petriti:** Përshëndetje! Anita Dautllari është një kryefamiljare që kemi rreth 3-4 vjet që ne e menaxhojmë si rast, e kemi mbështetur herë pas here me ndihma nga këshilli, po ashtu dhe me paketa ushqimore që ka patur për një periudhë kohore pa shkëputje. Tani për momentin nuk ka fond për zërin ndihma financiare.

Kemi diskutuar dhe me drejtoreshën e financës për gjetjen e një fondi dhe në një moment të ardhshëm do shohim mundësinë për t'i ardhur në ndihmë familjes së Anitës. Familja ka probleme shëndetësore dhe sociale, e kemi ndjekur si rast.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit Ermanda.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Duhet parë mbështetja me pjesën ushqimore dhe nga bashkia por dhe me subjekte private. Për pjesën financiare duhet parë me kujdes sa herë i ndihmojmë familjet në bazë të kriterëve që ka miratuar këshilli. Por si rast do ma adresoni ta shohim me përparësi.

**Server Xhuti:** Kam një shqetësim lidhur me parkingun e makinave ditën e mbledhjes së këshillit, nuk kemi vend parikimi.

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Maliqi ka vendparikimi plot, por do e shohim.

**Lulëzim Hoxhaj:** Për sa i përket zonjës ta ndihmojmë, sepse më duket shumë deilkate si situatë.

**Petrit Kupe:** Kam një shqetësim lidhur me ujin e pijshëm, nuk e kam tendecjoze, sepse kam qenë drejtes i Ujësellsit, por gjendja e ujit të pijshëm është përkeqësuar, këtu flas dhe si banor i Drithasit por dhe si Këshilltar i Nj.A Libonik.Mendoj se nuk po shkon në drejtimin e duhur për shkak dhe të rritjes së konsumit është përkeqësaur kudo furnizimi me ujë të pijshëm, këtë informacion e jap me siguri, duke filluar nga Vashtëmia, Drithas, Vloçisht, Symiz, Qesaratë dhe Libonik, në Drithas ku në bashkëpunim dhe me Bashkinë ne e kemi furnizuar me 24 orë ujë, ka rreth 10 ditë që furnizohet me ndërpreje.Duke qenë pranë këtij institucioni, në pozicionin e likujdatori, deklaroj se ka një mungesë vëmendje nga Ujësjellësit të Korçës, veçanërisht nga drejtoria teknike e këtij Ujësellësi, nuk kam venë re asnjë mbështetje për sektorin Maliq, Magazinat e Ujësjellësit Maliq kanë mungesë materiali.Janë kufizuar oraret me furnizimi me ujë, të gjithë vitet kanë patur temperatura të larta. Ujësjellësi i Maliqit nuk ka mbështetje, jo për shkak të reformës që ka ndërmarë qeveria, por për shak të mos angazhimit të drejtorisë teknike të Ujësjellësit Korçë.ky duhet të trajtohet si problem emergjent, si zjarri dhe përmbytja.Ti thrasim në raportim drejtuesit e Ujësjellsit Korçë.

**Faslli Zholi:** Jam dakord me shqetësimin e z.Petrit Kupe dhe unë e kam konstatuar këtë shqetëm dhe do e ngrija në mbledhje, doja të shtoja diçka, shoh që konsumohet ujë pa kriter, përdoret për vaditje.I sygjerojmë drejtorisë të ushtrojë sa më shumë kontroll për ta sistemuar këtë situatë.

**Aleksandra Spaho:** Kam dhe unë diçka lidhur me ujin, ku bëhen analizat e ujit? A është i pijshëm ose jo? Sidmos në pallate ku rrejtet janë shumë të vjetra, në bashkia ka dikus që bën analizat?

**Petrit Kupe:**Në lidhje me këtë, furnizimi me klor është bërë për 6 muaj, sa ne bënim për 1 muaj, ka një mungesë në klorifikim.

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:**Problemi i ujit është kompleks, unë nuk di isha shumë dakord që Ujësjellësi Korçës nuk po bën punë, por ndoshta nuk po e bën si duhet, për disa zona



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

të caktuara, në momentin që po flasim, po reabiltohen tetë Stacione Pompimi duke vendosur pompa të reja dhe që qëllimi kryesor i Ujësjetllësit të Korçës që menaxhon dhe Ujësjetllësin e Maliqit është të minimizojë shpenzimet me energji elektrike, ku Ujësjetllësi i Maliqit ka qenë problematik. Problemi i dytë ka të bëjë me abuzimin me ujën e pijshëm, gjithë andej dhe në qytetin e Maliqit vaditet me ujë të pijshëm, uji që vjen nga Kolaneci dhe Goça, ka ujë jo vetëm për Maliqin por dhe për Libonikun dhe Drithasin, nëse vaditet me ujë të pijshëm natyrisht që nuk do kesh ujë. Kemi dhe një takim për të pallafaquar furnizimin me ujë të pijshëm në të gjithë territorin e bashkisë. Administratorët edhe pse nuk e kanë detyrë por do sjellin situatën me furnizim me ujë të pijshëm për çdo fshat, për efekt të temperaturave të larta dhe të rënies të burimeve, kur mbledhen këto të gjitha, vuan ai që është i rregullt dhe uji nuk shkon në sasinë e duhur dhe në orarin e duhur. Ne kemi ndërhyrë në Ujësjetllësi dhe atje ku ka ndërhyrë Bashkia në shumicën prej tyre ka ujë 24 orë, por kjo në qoftë se lihet të bëhen lidhje të jashtë ligjshme dhe hiqen matësat do ketë kufizime në furnizim me ujë. Ndaj dhe një informacion që Ujësjetllësi i Korçës të vijë tja japë dhe Këshillit të Bashkisë këtu e ka detyrim, sepse ne si bashki jemi aksionerë të asaj shoqërie, drejtorja teknike të vijë të japë një informacion, problemi është që ajo që ne po e vuajmë në disa zona, të shpresojmë që do rregullohet shumë shpjet, zona të cilat do investohet shumë shpjet, si Plasa që po mbyllet tani, do kemi një rrejt të rri ujësjetllësi në Zvezdë, që do mbulojë dhe Burimasin me shtesë uji, por dhe Podgoria që janë zonat më të vështira për ujën e pijshëm dhe në Maliq ka patur ndërpreje, ne kemi bërë një investim me B.B në Maliq ku uji nuk është ndaluar asnjëherë. Ajo çka unë mendoj dhe ne jemi të gatshëm ta ndihmojmë ujësjetllësin me Policinë Bashkiake për të ndërprerë çdo linjë të jashtë ligjshme që vadit me ujë të pijshëm. Po të eliminojmë këtë, do kemi ujë për shumicën e fshatrave me orare të zgjatura, kam ekepsërincën e fshatit Maliq, kishte ujë 4 orë, bëmë rrejtin e brendshëm dhe tani kemi ujë 24 orë. Këtë ja kërkoj strukturave që meren me menaxhimin e ujit, nga reforma që qeveria po bën, Maliqi do marrë pjesën më të madhe të investimeve në Ujësjetllësi dhe Kanalizime, pasi bashkitë e tjera e kanë më mirë këtë situatë.

**Ornildi Demollari:** Lidhur me klorifikimin? Dhe për matjen laboratorike?

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Nuk e kam këtë informacion, për analizat e ujit i kryen Ujësjetllësi Korçë, është një laborator Gjerman.

**Enida Avdoli:** Në lidhje me analizat laboratorike të ujit, flas dhe nga eksperienca, janë Qendrat Shëndetësore ato që çojnë te Qendra Sanitare në mënyrë periodike një mostër të ujit të marrë në lagje ose fshatra sipas një grafiku të përcaktuar. Kështu nëse një lagje ose pallat i caktuar mund të ketë një ankesë, mund të çojë një mostër pranë Qendrës Shëndetësore dhe ajo e çon te Qendra Sanitare dhe si detyrim ligjor. Kjo bëhet me grafik sipas çdo fshati, kjo përsëritet disa herë për një periudhë 3 mujore, uji testohet vazhdimisht.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Aleksandra Spaho:** Ku duhet ta bëjmë këtë?

**Enida Avdoli:** Pranë Qendrës Shëndetësore Maliq.

**Faslli Zholi:** Duhet bërë pastrime se ka ujësjellsa që kanë defekte dhe vaditjet duhet të kontrollohen prandaj nuk ka ujë.

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Në Velitërnë nuk problem me ujin fshati por pallati dhe duhet parë dhe amortizimi i rjetit. për një ndërhyrje dhe ne po mendojmë dhe riparimin e soletës, ndoshta ajo e ka shkaktuar, janë pallate para vitit 1990.

**Idlir Limllari:** Në lidhje me pusët që hapen, duhet të bëhen me studim, ka ikur uji nga Gollobërda, Mançurishti, Progri.Faleminderit!

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Pusët që bën bashkia, i bën me studime gjeologjike.

**Idlir Limllari:** Në Gollobërdë dhe Mançurisht iku uji për shkak të pusit, është e mira të bëhen me studime.

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Në Mançurisht ka rënë niveli i liqenit e dimë këtë fakt.Në Burimas sapo kemi vënë në punë një pus të rri, të cilit po i bëhen analizat për ta parë dhe të shpresojmë që pas pastrimit që ju bë të jetë efektiv.Ujësijellsi Rajonal i Korçës mendon të hapë një pus midis Burimasit dhe Zvezdës, i cili mendojmë të zgjidhë problemin me ujë të pijshëm të të dy fshatrave.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit për të gjitha sygjërimiet, komentet, çështja e ujit është shumë delikate, shpresojmë të bëhet më e mira. Nëse nuk kemi diçka tjetër? Këto ishin pikat për sot. Faleminderit! Ditë të mbarë.  
Mbledhja mbyllet!

**Mbajtës Protokolli**

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Gertjan GJIRITI**

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ornildi DEMOLLARI**